



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 9.7.2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME VENDIN PRITËS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR”

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 9 korrik 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Bledar Çuçi. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja ka si qëllim kryesor përcaktimin e rregullave të funksionimit të Fondit, statusin ligjor dhe privilegjet e imunitetet e stafit që do të ushtrojë aktivitetin në këtë strukturë.

Me krijimin e një fondi të përbashkët, arritur me marrëveshjen “Për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor” në Pragë, më 13.11.2015, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje synohet realizimi i financimit të projekteve të vogla e të mesme në fusha si arsimi, kultura, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mjedisi dhe bashkëpunimi ndërkufitar.

Me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor vendet palë, Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova dhe Serbia dakordësuan që Shqipëria të jetë vendi pritës si dhe për vendosjen e selisë së Fondit në Tiranë.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-**Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
-**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATOR

Bledar ÇUÇI

KRYETARI

Ulsi MANJA